



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

26.02.2024, Prishtinë,  
Ref:05.02.2024\1499-2024

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Ereblina Vata kundër Indeksonline.net**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 21 shkurt 2024, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Ereblina vata kundër Indeksonline.net lidhur me publikimin e shkrimit me titull "Njihuni me 'Bebin', të dashurën aktuale të Bleros, qenka copë (Pamje)", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

## A R S Y E T I M

Media ka publikuar një lajm me titullin "Njihuni me 'Bebin', të dashurën aktuale të Bleros, qenka copë (Pamje)". Ankuesja pretendon se shkrimi bie ndesh me Kapitullin III (nxitja dhe gjuha e urrejtjes) të Kodit të Mediave.

Lajmi është shkruar në gazetë online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, andaj ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës, KMSHK gjen se ankesa është e bazuar. Pra, miratohet.

KMSHK pas leximit të ankesës dhe shkrimit të publikuar gjen se media ka raportuar me një gjuhë aspak të pranueshme për publikun dhe një gjuhë ofenduese për personin, për të cilin raporton. Media duhet të ketë parasysh Kodin e Etikës sa herë që boton një lajm, e sidomos kur ka të bëjë me persona, për të cilët interesi publik është zero.

Andaj, KMSHK vendos që ankesa të miratohet.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**